



# **CSR BOOKLET**

## 2018

# ARSIM:

- Dhuruam **4 bursa** të plota studimi për studentë me rezultate të shkëlqyera. **AlbChrome** ofroi bursa për tre studentë nga qyteti i Bulqizës, të cilët vazhdojnë studimet në Fakultetin e Gjeologji Minerave. Green Coast ofroi një bursë të plotë për një student nga Vlora, i cili studion në Fakultetin e Ekonomisë në degën Menaxhim Turizmi.
- AlbChrome nisi financimin e shkollës së mesme profesionale në Elbasan.
- AlbChrome mundësoi kabinetin e Informatikës për **700 nxënësit e shkollës** së mesme të bashkuar “Asllan Keta” në Fushë Bulqizë.
- Zhvilluam **6 leksione të hapura për mbi 600 studente**, në 2 universitete në Tiranë.
- Mbështetëm Konkursin Kombëtar të TBU. Grupi Balfin mbështeti konkursin kombëtar të organizuar nga Tirana Business University ku në fund u shpallën dhe fituesit për çdo kategori.






- Ju bashkuam programit të mentorimit për sipërmarrëset femra “Mentor with IMPACT”.
- Mbështetëm programin “Sipërmarrësit e Rinj të Tiranës”, ku **15 gjimnazistë** ndërtuan planet e biznesit për idetë e tyre origjinale.
- Nëpërmjet programit “Drejtues për një Ditë” mundësuar **3 vizita** të maturantëve të Tiranës në kompanitë e Grupit, të cilët në këtë eksperiencë unike u shoqëruan nga drejtuesit më të lartë të kompanive. Grupi Balfin ju bashkua programit “Drejtues për një ditë” organizuar nga Junior Achievement Albania, ku shoqëri të Grupit mirëpritën nxënësit maturantë të shkollave të mesme të vendit, të cilët u njohën me rolin e drejtuesit, me veprimtarinë e institucionit pritës, duke u informuar për një zgjedhje më të mirë për karrierën e tyre të ardhshme.
- Grupi Balfin nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Swisscontact për shkollat profesionale të mbështetura nga projekti “Aftësi për Punë”.
- Elektro-Servis mirëpriti nxënës të shkollave profesionale në vend, të cilët nisur nga dëshira e tyre e madhe për të mësuar si funksionon një servis i autorizuar, kanë vizituar ambientet e ndryshme të punës në kompani.





# MIRËRRITJE E FËMIJËVE:

- Kontribuam në rikonstruksionin e **2 kopshteve për fëmijë** në Dibër dhe Bulqizë.
- Kontribuam për **41 fëmijë** me aftësi të kufizuara. Falë suportit të Grupit Balfin, programi Tungjatjeta arriti të përçojë jehonën në çdo cep të vendit duke gjeneruar kontribute të shumta nga qytetarët shqiptarë. Spar Albania, si pjesë e Grupit Balfin, vijoi kontributin në kuadër të nismës duke personalizuar ujin Spar me etiketë të dedikuara e për çdo shishe të shitur dhuron 5 lekë në mbështetje të programit “Tungjatjeta”. Njëkohësisht Spar ka vendosur në dispozicion hapësirat pranë kasave në çdo supermarket, si një mënyrë për të ftuar këdo që ka dëshirë, të japë një kontribut sado të vogël për këta fëmijë në kutitë e donacionit, duke besuar se të gjithë bashkë mund të bëjmë shumë!
- **Neptun** mbështeti fëmijët me sindromën Down në Shqipëri, duke ju dhuruar fondin e mbledhur nga shitja e Kartave Happy si kontribut financiar shoqatave “**Down Syndrome Albania**” dhe “**Qendra Xhonatan**” për të ndihmuar në informimin, ndërgjegjësimin dhe përfaqësimin sa më të mirë të këtyre individëve në shoqëri.
- Mbi **600 fëmijë** të komunitetit rom, familjeve në nevojë, dheshtëpitë e foshnjës, kanë përfituar lodra dhe dhurata të shumta nga Jumbo, Spar, NetTrade, etj.



Në Shqipëri jetojnë 70,000 fëmijë me aftësi të kufizuara.

**Këta fëmijë kanë nevojë për ty!**

Dhuro tani dhe kontributi yt mund të përmirësojë jetën e tyre.

World Vision



- Nëpërmjet Fashion Group Albania dhuroam **ndihma në veshje për 600 gra**, vajza dhe fëmijë në disa qendra sociale në të gjithë Shqipërinë.

- **KidZone** ofroi në muajin Shtator kontributin e saj në pajisjen me çanta dhe mjete shkollore të **200 fëmijëve nga familje në nevojë**.

- Dhuroam për **46** fëmijë të policëve të vrarë. Përcollëm mesazhin se askush prej tyre nuk është vetëm në gëzimin e pragfestave.

- Për të tërhequr vëmendjen lidhur me rëndësinë e ushqyerjes së shëndetshme dhe luftimit të obezitetit tek fëmijët, **Neptun organizoi aktivitetin masiv në qendër të kryeqytetit "Ushqehu si Kampion"**.

- Grupi Balfin, për të disatin vit radhazi ka uruar festat e fundvitit nëpërmjet kartolinave të përgatitura nga **fëmijët e fshatrave SOS**. Kontributi për blerjen e kartolinave shkoi në ndihmë të këtyre fëmijëve.





**KONTRIBUT I DREJTPËRDREJTË I Z.SAMIR MANE NËPËRMJET “FONDIT BALFIN”**

# FAMILJE NË NEVOJË:

- Ndërtuam dhe mobiluam tërësisht **3 shtëpi të reja** për 3 familje në varfëri ekstreme. Tashmë familja Shira në Bulqizë, familja Sorra dhe familja Shima në Kashar, bëjnë një jetë me kushte dinjitoze.
- Vijuam me kontributin e përmuajshëm me ushqime për **5 familje në nevojë** në Kamëz, Tiranë, Lushnje, Burrel dhe Bulqizë.
- Nisëm ofrimin e **pensioneve ushqimore për dy familje** të reja në Delvinë dhe Peqin.



# SPONSORIZIME:

- Sponsorizuar aktivitetet e Bashkisë së Tiranës, Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve, Federatës Shqiptare të Shahut, etj.

# MBËSHTETJE PËR ARTIN:

- Gjatë vitit 2018 Grupi Balfin ka qenë një mbështetës i mirë i aktiviteteve dhe shfaqjeve teatrale duke mundësuar blerjen e biletave për punonjës nga çdo shoqëri për të qenë pjesë e tyre.

# MJEDIS:

- Nëpërmjet kompanive Spar Albania dhe Mane TCI kontribuam me qindra pemë në gjelbërimin e Tiranës.





Grupi Balfin është i vendosur që të promovojë vlerat më të larta shoqërore dhe të tregojë përkujdesje për komunitetin dhe ambientin. Ne besojmë se rritja e një biznesi duhet të shoqërohet paralelisht me zhvillimin dhe rritjen ekonomike dhe sociale të komunitetit ku ai vepron. Ne sigurohemi që bizneset tona të shërbejnë njëkohësisht si investime për përmirësimin e kushteve të punës, infrastrukturës, kujdesit shëndetësor, edukimit dhe kulturës në komunitetet në të cilat ato veprojnë. Shoqëritë e Grupit Balfin nuk kufizohen vetëm me sigurimin e vendeve të punës për komunitetet lokale në të cilat ato veprojnë por përpiqen të krijojnë një ndikim pozitiv në jetën familjare dhe në vend.

#### **BALFIN SOCIAL**

